

NË EMER TË POPULLIT

P.nr.77/2016

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Krimeve të Rënda, i përbërë nga gjyqtari Beqir Halili-Kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve Besnik Feka dhe Sabit Rama-anëtarë të trupit gjykues, në lëndën penale kundër të akuzuarave **H.G., L.K.** për shkak të veprave penale *Keqpërdorimi i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së* dhe të akuzuarave **H.S., V.J.** dhe **N.H.** për shkak të veprave penale *Keqpërdorimi i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, duke vendosur sipas aktakuzës së PP.I.nr.281/2015 të datës 07.07.2016, të cilën e përfaqëson prokurori Njazi Rexha, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datën me datën **23.10.2017** e shpalli, kurse me datë: **29.10.2017** e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.

1. I akuzuari **H.G.**, i biri i R. dhe Z. e gjinisë K. i lindur me datën ... në ... me vendbanim në fshatin ..., komuna e ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, nr personal ..., ka të kryer Fakultetin Juridik, i martuar, baba i katër fëmijëve, me profesion jurist – zyrtar i ..., i gjendjes së dobët ekonomike, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Nga data 17.11.2010 e gjere me datën 08.07.2013, ne cilësinë e personit zyrtar ne pozitën e ... në Komunë e Skenderajt, duke shfrytëzuar detyrën e tij Zyrtare tejkalon kompetencat e tij me qellim që tjetrit ti sjell dobi, ne atë mënyrë qe ne kundërshtim me ligjin nr. 03/L-226 për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se palujsheme ka japur ne shfrytëzim personave privat pronën e komunës pa miratimin e kuvendit te komunës dhe atë si vijon:

- Lokalin afarist nr. ... sipas kontratës nr ... datë ..., që gjendet në tribunën e stadiumit të futbollit në ngastrën kadastrale nr ..., zona kadastrale e ..., në sipërfaqe prej 40m/2, i është dhënë me qira H.I. me çmim për 200 euro për muaj.
- Lokalin afarist nr. ..., sipas kontratës nr ... datë: ..., që gjendet në tribunën e stadiumit të futbollit në ngastrën kadastrale nr. ... , zona kadastrale e ..., në sipërfaqe prej 40m/2, i është dhënë me qira A.N. me çmim prej 200 euro në muaj.
- Lokalin afarist nr. ... sipas kontratës nr ... datë: ..., që gjendet në tribunën e stadiumit futbollistik në ngastrën kadastrale nr. ..., zona kadastrale e ..., në sipërfaqe prej 40m/2, i është dhënë me qira H.J. me çmim prej 200 euro për muaj.

- Lokalin afarist nr. ... sipas kontratës nr. ... datë: ..., që gjendet në tribunën e stadiumit futbollistik në ngastrën kadastrale nr. ..., zona kadastrale e ..., në sipërfaqe prej 40m/2, i është dhënë me qira Q.Gj., prej 200 euro në muaj.
- Lokalin afarist nr. ... sipas kontratës nr. ... datë: ..., që gjendet në tribunën e stadiumit futbollistik në ngastrën kadastrale ... zona kadastrale ... në sipërfaqe prej 40m/2 i është dhënë me qira K.L. me çmim sipas komunës,
- Lokalin afarist nr. ..., sipas kontratës nr. ..., datë: ... që gjendet në tribunën e stadiumit futbollistik në ngastrën kadastrale ..., zona kadastrale ... në sipërfaqe prej 40 m/2 i është dhënë me qira A.M. me çmim sipas komunës,
- Lokalin afarist nr. ... sipas kontratës ... datë: ..., që gjendet në tribunën e stadiumit futbollistik në ngastrën kadastrale ..., zona kadastrale ... në sipërfaqe prej 40 m/2, i është dhënë me qira B.H., nga datë: ... me çmim sipas komunës.
- Në kundërshtim me Ligjin nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pasurisë së paluajtshme ka japur në shfrytëzim personave privat pronën e komunës pa miratimin e Kuvendit të komunës dhe pa procedurat e hapura si vijon:
- Lokalin afarist nr. ..., sipas kontratës nr. ... datë: ..., që gjendet në tribunën e stadiumit futbollistik në ngastrën kadastrale ..., zona kadastrale ... në sipërfaqe prej 40 m/2, i është dhënë në qira S.I.1 me çmim sipas komunës.
- Lokalin afarist nr. ..., sipas kontratës ... dt: ..., që gjendet në tribunën e stadiumit futbollistik në ngastrën kadastrale ..., zona kadastrale ... në sipërfaqe prej 40 m/2, i është dhënë me qira B.I, sipas çmimit të komunës.
- Lokalin afarist nr. ... , sipas kontratës ... dt: ... që gjendet në tribunën e stadiumit futbollistik në ngastrën kadastrale ..., zona kadastrale ... në sipërfaqe prej 40m/2 i është dhënë në qira Q.O. në fillim të muajit janar të vitit 2014 me çmim sipas komunës.
- Lokalin afarist nr. ... sipas kontratës ... datë ... që gjendet në tribunën e stadiumit futbollistik në ngastrën kadastrale ..., zona kadastrale ... në sipërfaqe prej 40 m/2 i është dhënë me qira B.D., me fillim nga dt: ... me çmim sipas komunës.
- Lokalin afarist nr. ... sipas kontratës ... dt: ... që gjendet në tribunën e stadiumit futbollistik në ngastrën kadastrale ..., zona kadastrale ... në sipërfaqe prej 40m/2, i është dhënë me qira R.L., nga dt: ... me çmim sipas komunës.
- Lokalin afarist sipas kontratës nr. ... dt. ... që gjendet në objektin e komunës (përballë byfesë) evidentohet në ngastrën kadastrale nr. ... në rrugën “...” ..., i është dhënë me qira Xh.Sh., në kohëzgjatje prej katër (4) viteve me çmim prej 91 euro për muaj.

II. Tokat në pronësi së komunës së Skënderajit që janë dhënë në shfrytëzim të përkohshëm personave privat në kundërshtim me Ligjin 03/L-226 si vijon:

- Prona në ngastrën kadastrale nr. ... në sipas aktvendimit ... dt. ..., në sipërfaqe prej 1.000 m/2, në zonën kadastrale ... i është dhënë në shfrytëzim B.G., për ndërtimin e fushës së sportit të futbollit të vogël për interes të biznesit privat,
- Prona në ngastrën kadastrale nr. ..., sipas aktvendimit nr. ... dt: ..., në sipërfaqe prej 16 m/2 në zonën kadastrale ... i është dhënë shfrytëzim F.H., më qëllim të vendosjes së

kioskut për nevojat e ndërmjarrjes për shitjen e biletave të udhëtarëve, çmimi i qerasë për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren Komunale në fuqi.

- Prona në ngastrën kadastrale nr.240 sipas aktvendimit nr. ... dt: ... në sipërfaqe prej 16 m/2 në zonën kadastrale ... i është dhënë në shfrytëzim M.A. me qëllim të vendosjes së kioskut për nevojat e shitjes së biletave të udhëtarëve, çmimi i qerasë për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren Komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale nr. ..., sipas aktvendimit nr. ... dt: ..., në sipërfaqe prej 9 m/2 në zonën kadastrale ... i është dhënë në shfrytëzim B.K., me qëllim të vendosjes së kioskut për zhvillimin e veprimtarisë të Agjensionit turistik, çmimi i qerasë për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren Komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale nr. ..., me aktvendimin nr. ... dt. ..., në sipërfaqe prej 120 m/2 në zonën kadastrale në ... i është dhënë S.Xh., në shfrytëzim të përkohshëm toka nga prona publike komunale me qëllim të ndërtimit të vetëshërbimit dhe hapjes së servisit ndërtimor për shitje të mallrave të ndryshëm për zhvillimin e biznesit privat, çmimi i qerasë për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale nr. ... sipas aktvendimit ... dt. ..., në sipërfaqe prej 56 m/2 zona kadastrale në ..., i lejohet H.A., në shfrytëzim të përkohshëm toka nga prona publike komunale me qëllim të ndërtimit të objektit të përkohshëm për ushtrimin e biznesit privat të tij, çmimi i qerasë për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren Komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale nr. ... sipas aktvendimit nr ... dt. ..., në sipërfaqe prej 28 m/2 në zonën kadastrale ..., i lejohet M.B, në shfrytëzim të përkohshëm toka nga prona publike, në vendin ku e ka të vendosur me parë objektin e përkohshëm, me qëllim të ushtrimit të biznesit privat, çmimi i qerasë për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren Komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale nr ..., sipas aktvendimit nr ... dt. ..., në sipërfaqe prej 0.02, 00ha, në zonën kadastrale ..., i lejohet B.F., në shfrytëzim të përkohshëm toka nga prona publike komunale me qira, me qëllim të ndërtimit të objektit të fermës, për zhvillimin e biznesit të veprimtarisë bujqesore, çmimi i qerasë për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale nr ..., sipas aktvendimit nr ... dt. ..., në sipërfaqe prej 10 m/2 në zonën kadastrale në Tyriqevc, i lejohet S.I.2 në shfrytëzim të përkohshëm toka nga prona publike komunale me qira me qëllim të vendosjes së kioskut për shitjen e artikujve të ndryshëm për biznes privat, çmimi i qerasë për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale nr. ... sipas aktvendimit nr. ... dt. ..., në sipërfaqe prej 72 m/2 në zonën kadastrale ..., i lejohet H.K., në shfrytëzim të përkohshëm toka nga prona publike komunale me qira me qëllim të vendosjes së objektit për shitjen e artikujve të ndryshëm bujqesore e tjera, për biznes privat, çmimi i qerasë për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale nr. ... sipas aktvendimit nr. ... dt. ... në sipërfaqe prej 42 m/2 në zonën kadastrale ..., i lejohet Sh.H., në shfrytëzim të përkohshëm toka nga prona publike komunale me qira me qëllim të vendosjes së objektit të përkohshëm për

ushtrimin e biznesit privat, çmimi i qerases per m/2 caktohet sipas tarifës se caktuar me rregulloren komunale ne fuqi.

- Prona ne ngastrën kadastrale nr. ... sipas kontratës nr ... dt. ... ne sipërfaqe prej 120 m/2 ne zonën kadastrale ..., prapa shtëpisë se Kultures i eshte dhene ne shfrytëzim pronarit te diskotekës “ ... “ ..., nga dt. 18 qershor deri me dt. 10 shtator 2012, me qellim te ushtrimit te veprimtarisë te organizimit te këngëve dhe lojërave, me çmim prej 150 euro ne muaj.

Tokat ne pronësi te komunës se Skenderajit qe janë dhene ne shfrytëzim te përkohshëm personave private ne kundërshtim me Ligjin nr. 04/L-144 jane si vijon:

- Prona ne ngastrën kadastrale nr. ... sipas aktvendimit nr ... dt. ... ne zonën kadastrale ... i eshte dhene me qira M. (K.) B., me qellim te nderimit te terraces qe tja bashkangjes objektit te saj ekzistues per ushtrimin e biznesit afarist, çmimi i qerases per m/2 caktohet sipas tarifës se caktuar me Rregulloren komunale ne fuqi.
- Prona ne ngastrën kadastrale nr. ... sipas aktvendimit nr. ... dt. ... ne sipërfaqe prej 60 m katror ne zonën kadastrale ..., i eshte dhene ne shfrytëzim R.Gj., me qellim te ushtrimit te biznesit privat, pagesa e qirasë behet nga viti 2010 e tutje.
- Prona ne ngastrën kadastrale nr. ..., sipas aktvendimit nr. ... dt. ..., ne sipërfaqe prej 40 m/2 ne zonën kadastrale ..., i eshte dhene ne shfrytëzim te përkohshëm H. (V.) J., ne vendin ku ka pasur te vendosur me pare objektin e përkohshëm, me qellim te ushtrimit te veprimtarisë zejtare, çmimi i qerases per m/2 caktohet sipas tarifës se caktuar me Rregulloren komunale ne fuqi.
- Prona ne ngastrën kadastrale nr. ... sipas aktvendimit nr. ... dt. ..., ne sipërfaqe prej 32 m/2 ne zonën kadastrale ..., i eshte dhene ne shfrytëzim F.D. ne vendin ku e ka objektin e zejtarisë private, i vendosur ne pronën publike me qellim te ushtrimit te biznesit privat, çmimi i qerases per m/2 caktohet sipas tarifës se caktuar me Rregulloren komunale ne fuqi.
- Prona ne ngastrën kadastrale nr. ... sipas aktvendimit nr. ... dt. ... ne sipërfaqe prej 24 m/2 ne zonën kadastrale ne ..., i eshte dhene ne shfrytëzim H.D., per vazhdimin e ushtrimit te biznesit privat te tij, ne vendin ku eshte i ndërtuar me pare objekti per biznes, çmimi i qerases per m/2 caktohet sipas tarifës se caktuar me Rregulloren komunale ne fuqi.
- Prona ne ngastrën kadastrale nr. ...0 sipas aktvendimit nr. ... dt. ... ne sipërfaqe prej 70 m/2 zona kadastrale ...-..., i eshte dhene ne shfrytëzim A.H.1 per vazhdimin e ushtrimit te biznesit privat te tij, çmimi i qerases per m/2 caktohet sipas tarifës se caktuar me Rregulloren komunale ne fuqi.
- Prona ne ngastrën kadastrale nr. ...-..., sipas aktvendimit nr. ... dt. ..., ne sipërfaqe prej 2.00.00ha, ne zonën kadastrale ..., i eshte dhene me qira firmës “...” sh.p.k. drejtorit B.B., me qellim te ushtrimit te veprimtarisë per nxjerrjen dhe përpunimin gjegjësit bluarjen e gurit per shitje, çmimi i qerases per m/2 caktohet sipas tarifës se caktuar me Rregulloren komunale ne fuqi.
- Prona ne ngastrën kadastrale nr. ..., sipas aktvendimit nr. ... dt. ..., ne sipërfaqe prej 120 m/2 ne zonën kadastrale ne ..., i jepet ne qira F.B. per vendosjen e objektit te

përkohshëm me qëllim të ushtrimit të biznesit privat “Autolarje”, çmimi i qerases për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren komunale në fuqi.

- Prona në ngastrën kadastrale nr. ..., sipas aktvendimit nr. ... dt. ..., në sipërfaqe prej 35 m/2 në zonën kadastrale në ..., i është dhënë me qira G.Gj. në vendin ku e ka objektin e zejtarisë private i vendosur në pronën publike me qëllim të ushtrimit të biznesit privat, çmimi i qerases për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale nr. ..., sipas aktvendimit nr. ... dt. ..., në sipërfaqe prej 35 m/2 në zonën kadastrale në ..., i është dhënë në qira Xh.Gj., në vendin ku e ka objektin e zejtarisë private i vendosur në pronën publike me qëllim të ushtrimit të biznesit privat, çmimi i qerases për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale nr. ..., sipas aktvendimit nr. ... dt. ..., në sipërfaqe prej 39 m/2 në zonën kadastrale në ..., i lejohet A.Q. në shfrytëzim të përkohshëm toka nga prona publike komunale me qira në vendin ku e ka të blerë objektin e zejtarisë private i vendosur në pronën publike me qëllim të ushtrimit të biznesit privat, çmimi i qerases për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren komunale në fuqi.
- Prona në ngastrën kadastrale ..., sipas kontratës nr. ... dt. ..., në sipërfaqe prej 300 m/2 në zonën kadastrale në ..., i lejohet NTSH “...” nga ..., drejtor V.S., toka publike komunale në shfrytëzim të përkohshëm me qira, me qëllim të vendosjes së lodrave për lojërë të fëmijëve, për ushtrimin e biznesit afarist privat, çmimi i qerases për m/2 caktohet sipas tarifës së caktuar me Rregulloren komunale në fuqi.
- Me këto ka kryer veprën penale në vazhdim – *Keqperdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 81 të KPRK.*

2. I akuzuari **L.K.**, me nofkën L., i biri i A. dhe Sh., e gjinisë D., e lindur me datën ... në fshatin ..., komuna e ... ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ..., ka të kryer Fakultetin Juridik, i martuar, me profesion jurist – ..., gjendjes së mesme ekonomike, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Nga data 31.03.2014 e gjerë me datën 15.02.2015 në cilësinë e personit zyrtar në pozitën e ... në Kuvendin Komunal në Skënderaj duke shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare tejkalon kompetencat e tij me qëllim që tjetrit ti sjellë dobi në ata mënyrë që ka lidhur kontratat mbi dhënien e lokaleve afariste me qira në kundërshtim me **Ligjin nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 23/2013** pa miratimin e kuvendit komunal dhe pa procedurat e hapura duke i dhënë me qira lokalet afariste si vijon:

- Lokalin afarist nr. ... qe eshte ne objektin nen tribunën e stadiumit te futbollit ne ngastrën kadastrale nr. ... zona kadastrale ..., sipas kontratës nr. ... dt. ..., i ipet S.I.3, ne shfrytëzim te përkohshëm me qira, me pagese te qerese mujore sipas çmimit te caktuar nga komuna duke filluar nga fillimi i muajit prill 2014, me qellim te ushtrimit te biznesit privat te tij.
- Lokalin afarist nr. ..., qe eshte ne objektin nen tribunën e stadiumit te futbollit i ndërtuar ne ngastrën nr. ..., Zona Kadastrale ..., sipas kontratës nr. ... dt. ... i ipet A.H.2 ne shfrytëzim te përkohshëm me qira me pagese te qirasë mujore sipas çmimit te caktuar nga komuna duke filluar nga fillimi i muajit tetor 2014, me qellim te ushtrimit te biznesit privat te tij.
- Lokali afarist nr. ..., qe eshte ne objektin nen tribunën e stadiumit te futbollit i ndërtuar ne ngastrën nr. ..., Zona Kadastrale ..., sipas kontratës nr. ... dt. ..., i ipet S.S. ne shfrytëzim te përkohshëm me qira me pagese te qirasë mujore, sipas cmimit te caktuar nga komuna duke filluar nga fillimi i muajit shtator, me qellim te ushtrimit te biznesit privat te tij.
- Lokalin afarist nr. ..., qe eshte ne objektin nen tribunën e stadiumit te futbollit, i ndërtuar ne ngastrën kadastrale ..., Zona Kadastrale ..., sipas kontratës nr. ... dt. ... i ipet A.I. ne shfrytëzim te përkohshëm me qira me pagese te qirasë mujore sipas çmimit te caktuar nga komuna duke filluar nga data e lidhjes se kontratës me qellim te ushtrimit te biznesit privat te tij,
- Me kete ka kryer veprën penale ne vazhdim – Keqperdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 e lidhur me nenin 81 te KPRK-së.
-

- Me ketë ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Në bazë të dispozitave të nenit 41, 45, 73, dhe nenit 365 e 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së,
i

G J Y K O N

- 1. Të akuzuarin H.G., me dënim burgu në kohëzgjatje pre gjashtë (6) muajve,**
- 2. Të akuzuarin L.K., me dënim burgu në kohëzgjatje pre gjashtë (6) muajve**

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj shumën prej 50 Euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Pas shpalljes së aktgjykimit Kryetari i trupit gjykues i njoftoj të akuzuarit se me pëlqimin e tyre dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve mund të zëvendësohet me dënim me gjobë.

I akuzuari H.G. deklaroj se pranoj që dënimi me burg të më zëvendësohet me gjobë.

I akuzuari L.K. deklaroj se pranoj që dënimi me burg të më zëvendësohet me gjobë.

Gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 47 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dënimin me burg në kohëzgjatje prej nga gjashtë (6) muajve të akuzuarve H.G. dhe L.K. u ZAVENDËSOHEN ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej nga njëmijetëqind (1800) Euro.

Te akuzuarit obligohen që shumën prej njëmijetëqind (1800) Euro, ta paguajnë në afat pre 3 muajve, pas formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë gjobën, gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu qe 1 ditë burg llogaritet me 20 Euro.

II.

Në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP-së,

Të akuzuarit **H.S., V.J.** dhe **N.H.** me shënime si në shkresat e lëndës.

LIROHEN NGA AKTAKUZA

SEPSE:

Me datën 31.01.2012 në Skenderaj i akuzuari **H.S.** në cilësinë e ... për hapjen e ofertave përkitazi me dhënien e tokës në shfrytëzim për ndërtim dhe menaxhimin e tregut të gjelbërt në Skënderaj dhe të akuzuarës **V.J.** dhe **N.H.** në cilësinë e ... i tejkalojnë kompetencat e tyre me qëllim që personit tjetër ti sjellin dobi pasurore në atë mënyrë që me rastin e hapjes të ofertave kanë kualifikuar për procedurë seleksionimi kompaninë NTSH “ ... “ pa plotësuar kriteret e kërkuara nga dosja e tenderit në pikën III.2 nën “ c “, duke dorëzuar vërtetimin e Gjykatës Ekonomike më të vjetër se tre muaj, pikën III.2.2 pika 3 (kapaciteti ekonomik dhe financiar) duke dorëzuar dëshmi nga banka në të cilën dëshmi nuk është cekur 30.000 Euro dhe pikën III.2.3 nën 1 dhe nën 2 (kapaciteti teknik dhe profesional) – mungon përvoja e punës për menaxhmentin e projektit dhe personelin teknik dhe ka fituar tenderin për ndërtimin dhe menaxhimin e tregut të gjelbërt.

- Me këtë kishin për te kryer veprën penale *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 31.*

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

I. AKTAKUZA

Prokuroria Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.281/2015 të datës 07.07.2016, kundër të akuzuarave H.G., L.K. për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe të akuzuarave H.S., V.J. dhe N.H. për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda Njazi Rexha në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: qe në fillim bëjë përmisim në dispozitivin e IV te aktakuzës ashtu qe ne rendin e dyte pas fjalës per hapjen fshihet dhe vlersimit vazhdon teksti vijues: ne rendin e gjashte pas fjalës e hapjes fshihet dhe vlerësimit vazhdon teksti vijues, ndërsa ne rendin e tete dhe te nente fshihet fjalia nen piken 3.2 nen c, duke dorëzuar vërtetimin e Gjykates Ekonomike me te vjetër se tre muaj, vazhdon teksti vijues. Pas mbajtjes se shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit te provave u vërtetua se te akuzuarit kane kryer veprat penale per te cilat ngarkohen me aktakuze. Nuk eshte kontestuese se i pandehuri H.G. ne cilësinë e personit zyrtar nga viti 2010 e gjere me datën 08.07.2013 ka qene ne pozitën e ... , ne komunën e Skenderajit, ndërsa i pandehuri L.K. ka qene ne cilësinë e personit zyrtar ne periudhën 31.03.2014 gjere me 15.02.2015 ne ... dhe se gjate ushtrimit te këtyre dy funksioneve dy te pandehurit kane tejkualuar kompetencat e tyre dhe ne kundërshtim me Ligjin 03/L-226 dhe 04/L-144 kane dhene ne shfrytëzim dhe këmbim pasurinë e paluajtshme personave private pa miratimin e kuvendit komunal ne Skenderaj. Sipas dy te pandehurve L.K. dhe H.G., lokalet dhe token ne pronësi shoqerore ne shfrytëzim personave private u kane dhene ne baze te Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal dhe Rregullores Komunale ne fuqi.

Sipas Ligjit nr. 03/L-226 per dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te komunës neni 5 par. 1 percakton: “kuvendi komunal e ka te drejtën te jep personave fizike dhe juridike pronën e paluajtshme publike komunale per shfrytëzim afatshkurter dhe afatgjate”. Neni 5 par.2 percakton “kuvendi komunal ka te drejte te jap ne shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale deri ne afat prej 10 vitesh ne përputhje me kriteret e përcaktuara me Ligjin per Prokurimin Publik.

Sipas Ligjit nr. 04/L-144 per dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te komunës neni 5 par.1 percakton se: procedura per dhënien e pronës e paluajtshme komunale ne shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes konkurrencës se hapur publike dhe procedurave te parapara me ligj. Ndersa neni 5 par. 2 i po këtij ligji percakton: per dhënien e pronës se paluajtshme komunale per shfrytëzim afatshkurtër konkursi i hapur publik eshte ne formën e ankandit publik.

Sipas Rregullores se Qeverise se Republikes se Kosoves, nr. 23/2013 neni 5 par.2 percakton: prona e paluajtshme e komunës qe nuk ka marre miratimin paraprak nga kuvendi i komunës nuk mund te jepet ne shfrytëzim përmes ankandit publik.

Dy te pandehurit me rastin e dhënies se lokalit dhe tokave private fare nuk kane respektuar ligjet ne fjale, e ne baze te deklarateve te tyre te dhëne ne zyrën e prokurorisë dhe ne seancën gjyqesore rezulton se per këto ligje janë informuar vetëm atëherë kur janë marre ne pyetje ne polici.

Nese i shikojmë me vëmendje te gjitha kontratat e lidhura kane datën e lidhjes, por asnjëra prej tyre nuk e ka datën e mbarimit. Nuk qëndron konstatimi i te pandehurve se te lidhja e kontratës nuk eshte përcaktuar afati per arsye se vete kontrata nënkupton nje vit fiskal. Mirepo ne pytjen e parashtruar gjate seancës gjyqësore te pandehurit L.K. se a mund te na tregosh se me cilën dispozite ligjore eshte përcaktuar afati nje vjeçar sipas Ligjit mbi Financat Publike, deklararon se decidivisht nuk e din se cila eshte ajo dispozite. Nga deklarata e H.G., dhene ne shqyrtimin gjyqësor rezulton se këto lokale dhe toka nuk janë ne shfrytëzim per periudhën 1 vjecare, mirëpo nga deklarata e dhene ne zyrën e prokurorisë deklararon, citoj: “ne nuk kemi shkuar sipas Ligjit nr. 03/L-226 se sikurse te kishim zbatuar kete ligj asnjëri prej qytetareve nuk do te konkuronte, per marrjen me qira te këtyre lokale mirëpo ne ju kemi japur këto lokale pa aprovimin e kuvendit komunal duke mos ju caktuar nje afat kohor dhe ne momentin kur paraqitet nevoja e komunës ta marrim ne cdo kohe”, qe nënkupton se me vetëdije nuk kane dhene lokalet dhe tokat ne shfrytëzim personave private per afat njëvjeçar sic e quajnë vit fiskal.

Poashtu edhe i pandehuri L.K., ne deklaratën e dhene ne zyrën e prokurorisë deklaroi, citoj: “kam nënshkruar dy kontrata per dhënien ne shfrytëzim te përkohshëm te pronës se komunës qe eshte nje lokal-objekt ne kohe te pacaktuar”, qe nënkupton se ka qene i vetëdijshëm se nuk ka lidhur kontrate nje vjeçare”.

Per bindjen e gjykatës se kontratat nuk janë lidhur per afat 1 vjecar ashtu sic pretendohet nga ana e dy te pandehurve si kontrata fiskale kemi lidhjen e kontratës nr ... dt. ... per dhënien e lokalit ne objektin e komunës ne kohëzgjatje prej katër vitesh me çmim prej 91 euro per muaj. Shtrohet pyetja po këtu a kemi kontrate 1 vjecare, e cila kontrate eshte lidhur pa miratimin e kuvendit te komunës.

Sa i përket te akuzuarve H.S., V.J. dhe N.H., eshte i pakontestueshëm fakti se qe te tre, H.S. ne cilësinë e ... dhe V.J. dhe N.H., kane bere parakualifikimin e operatoreve ekonomike pa bere shqyrtimin e dokumentacionit ne menyre detale, duke i anashkaluar kriteret e domosdoshme per plotësim, per kualifikimin e nje operatori ekonomik sic eshte rasti te operatori ekonomik “...”. Eshte i pakontestueshem fakti se te ky operator ekonomik ekziston mbështetja bankare, por nuk kemi mbështetje ne shumen e cekur prej me se paku 30.000 EURO sic kërkohet. Po ashtu edhe personeli teknik sic eshte menaxheri i projektit dhe personeli tjetër teknik, inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë dhe inxhinieri i diplomuar i arkitekturës nuk kane poseduar përvojën e punës prej se paku tri vitesh, gjegjësisht dy viteve sic eshte parapare ne kriteret e dosjes se tenderit. Gjate këtij shqyrtimi u pohua edhe nga vete anetaret e komisionit se këta kane bere vetëm shqyrtimin fizik te dokumentacionit te operatoreve ekonomike duke anashkaluar kontrollimin detal te dokumentacionit ashtu sic parashihet nga raporti i parakualifikimit te ofertave per ndërtimin dhe menaxhimin e tregut te

gjelbert ne Skenderaj. Nuk qëndron konstatimi se si komision nuk kane pasur fuqi ekzekutive por ky komision eshte ai qe ka bere edhe eliminimin e dy operatoreve ekonomik ... dhe

Andaj duke pasur parasysh te cekura te evidentuara ne dokumentacionin përkatës i propozoj gjykatës qe te pandehurit ti shpall fajtores per veprat e kryera penale e me rastin e caktimit ne llojit dhe lartësisë se dënimit ti kete parasysh rrethanat lehtesuse dhe renduese te parapara me ligj.

II. MBROJTJA

II.1.Në fjalën përfundimtare i akuzuari i parë **H.G.** kërkoi qe ne baze te dispozitave te nenit 364 te KPP te nxjerr aktgjykim lirues dhe te shpallet i pafajshëm per te gjitha pikat e aktakuzës pasi qe me veprimet e mia nuk kam kryer kurrfarë vepre penale pasi qe kontratat te cilat i kam nënshkruar e per te cilat jam i akuzuar i kam nënshkruar ne baze te dispozitave te Rregullores se brendshme te komunës 01 Nr 110-83 per organizimin dhe përgjegjësitë e organeve te administratës komunale te dates: 01.12.2011 te Skenderajit.

Ne nenin 10 par.1 faqe 25 dhe 26 thote: kompetencat e drejtorisë per kadastër, gjeodezi dhe pronë janë: pika 23 “lidh kontrata mbi dhënien me qira te tokës ndertimore”, pika 24 “udhëheq me kadastrin etazh te banesave dhe menaxhon me banesat dhe objektet tjera te komunës dhe mban evidencën per to”.

Sipas Rregulloreve komunale te viteve 2010,2011,2012, 2013 per taksa, tarifa dhe gjoba taksat komunale mbi shfrytëzimin e përkohshëm te tokës dhe pagesa e qirasë te tokës fq. 11 neni 9.1 thote “kërkesat per marrjen ne shfrytëzim te përkohshëm token si prone komunale ne territorin e komunës se Skenderajit qytetaret mund ti drejtohen ne Drejtorine per Gjeodezi, Kadaster dhe Prone”. Toka gjegjësisht hapësirat e tyre, prone komunale u jepen ne shfrytëzim me qira” dhe gjithashtu duke u bazuar ne rregulloren e brendshme te komunës 01 Nr 110-83 te dates 01.12.2011 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësit e organeve te Administratës Komunale.

2.Në fjalën përfundimtare i akuzuari i dytë **L.K.** ka deklaruar ne mes tjerash se veprimin tim per lidhjen e katër kontratave te dhënies me qira ne shfrytëzim te përkohshëm nga 0 deri 1 vit e ka cilësuar si veprim te drejte ne përputhje me ligjet ne fuqi dhe interesat e përgjithshme te komunës dëshmitari F.N. i cili ne cilësinë e ... ka dëshmuar ne shqyrtimin gjyqësor te mbajtur me 30.06.2017 ku ka potencuar se citoj:

“Ligji Nr.04/L-144 qe është referuar prokurori nuk parasheh procedura per dhënien e pronave ne afat njëvjeçar per shfrytëzim dhe çështjen e kësaj procedure e rregullojnë komunat me rregullore te brendshme ne kuadër te rregullores per taksa, ngarkesa dhe gjoba, kjo ka qene e rregulluar me rregullore e eshte e rregulluar dhe tash. Rregullore te cilat i nënshtrohen vlerësimit te detyrueshëm te ligjshmërisë konform nenit 81 te Ligjit te Veteqeverisjes Lokale, e cila cdo vit marrin konfirmimin e ligjshmërisë nga MAP dhe Ministria e Financave.

Prandaj konstatoj se ... nuk i kane tejkaluar autorizimet sepse kane vepruar konform nje rregulloreje e cila eshte miratuar ne Kuvendin e Komunes dhe i eshte nënshtruar vlerësimit te ligjshmërisë.

Dhenia e këtyre pronave eshte bere duke u respektuar ne ploteni parimet: sic eshte parimi i ligjshmërisë, parimi i efikasiteti, parimi i ruajtjes se ambientit, parimi i rritjes se vlerës se asaj prone dhe eshte respektuar ne ploteni plani zhvillimor komunal urban”.

Pra pronat as nuk janë shitur as nuk janë tjetërsuar (nuk i është ndërruar titullari) por vetëm janë dhene me qira sipas akteve të plotefuqishme juridike duke mundësuar krijimin e të hyrave për komunën dhe investimin e atyre të hyrave nga komuna në projekte të rëndësishme me interes të përgjithshëm për qytetaret e komunes sonë.

Gjykates i propozoj që në pajtim me nenin 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të marr Aktgjykim Lirues për të akuzuarin L.K. duke e shpallur të pafajshëm për të gjitha pikat e ngritura me aktakuzën P.nr.77/16.

II.

Në fjalën përfundimtare **i akuzuari i tretë H.S.** deklaroi: se pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor dhe pas paraqitjes së fjalës përfundimtare të prokurorit si i akuzuar vlerësoi se me asnjërin nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se unë kam kryer veprën penale për të cilën akuzohem. Në veprimet e mia nuk manifestohen elementet qenesore që përbejnë figurën e kësaj vepre penale sepse nga gjendja e vërtetuar e fakteve nuk del se ekzistojnë prova të cilat do të tregonin se kam kryer veprën penale ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës. Në mbështetje të vendimit mbi emërimin e anetareve të komisionit për hapjen e ofertave nr ... të dt: ... marrë nga kryetari i komunës së Skenderajt unë si i akuzuar kam marrë pjesë vetëm në komisionin për hapjen e ofertave, jo në komision për ekzaminimin krahasimin dhe vlerësimin e ofertave gje e cila shihet nga po ky vendim në nenin 2 në të cilën decidivisht përshkruhen detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Prokuroria më ngarkon mua dhe dy të akuzuarit tjerë se më rastin e hapjes dhe vlerësimet të ofertave kinse kemi kualifikuar për procedurë seleksionimi kompaninë ofertuese NTSH "...” në Skenderaj pa i plotësuar kriteret e kërkuara nga dosja e tenderit që është pretendim krejtësisht i paqëndrueshëm dhe i pabazuar në raport me provat nga shkresat e lëndës ngase bazuar në vendimin nr ... të datës ... si më lartë ky komision ka shqyrtuar prima facie ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë i cili aprovohet nga raporti për parakualifikimin e ofertave në të cilin raport konstatohet qartë se të njëjtit kanë proceduar për fazën e dytë tri kompani e asesi "nuk kanë favorizuar" apo përzgjedhur përfundimisht kompaninë ofertuese në fjalë. Në si komision kemi pasur për detyrë shqyrtimin në detaj të të gjitha dokumentacioneve por vetëm kemi shikuar sipas kriterëve të kërkuara a janë dorëzuar këto dokumente dhe a i janë bashkangjitur ofertës apo dosjes së tenderit. Gjykates i ka propozuar që të lirohem nga përgjegjësia penale.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarës V.J. **Av.V.Rr.** deklaroi: në këtë proces gjyqësor prokuroria e shtetit klienten time e ka ngarkuar me veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPP. Në dispozitivin e kësaj aktakuzës e mbrojtua ime ngarkohet me tejkallim të autorizimit gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Gjatë gjithë procesit dhe nga provat që janë nxjerre dhe nga dëshmia e dëshmitarit të vetëm në këtë proces prokuroria nuk ka arritur që të argumentoj në qoftëse edhe plotësimin e ndonjë elementi të vetëm të veprës penale për të cilën e mbrojtura ime po akuzohet. I nderuar trupi gjyqësor vepra penale nga paragrafi 422 kryhet me tri veprime: keqpërdorim detyrës zyrtare, tejkallim dhe moskryerjen e detyrave zyrtare. Mirepo për të ekzistuar vepra penale respektivisht për të konsumuar dhe për të shpallur fajtor personi i akuzuar njeri nga këto tri veprime siç është tejkallimi duhet të bashkangjiten edhe elementet si në vijim: sigurimi për veten apo personin e tjetër, çfarëdo dobie pasurore si materiale dhe jo materiale konkrete, ose të shkaktohet dëmi dikujt ose seriozisht të shkelen të drejtat e personit tjetër. Nga shkresat e

lendes, nga provat qe prokuroria ka ofruar me asnjë prove te vetme nuk ka mundur ta argumentoj qëllimin sic pretendohet ne dispozitiv te aktakuzës, edhe me masat e marra gjate hetimit ato te hetimit dhe te vëzhgimit nuk ka rezultuar asnjë prove me te cilën do te dokumentohej se e mbrojtura ime duke kryer detyrën e saj zyrtare te kete përfituar per veten, personin tjetër apo te kete shkaktuar qfare do demit apo te kete shkaktuar dem dikujt tjetër, cka do te thotë cdo keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk perben vepër penale. Veprimet ne fjale mund te tërheqin pas vetes përgjegjësi disiplinore apo çfarëdo perveq përgjegjësisë penale. E mbrojtura ime ne komisionin per hapjen e ofertave ka qene ... e këtij komisioni, detyre e këtij komisioni ka qene vetëm hapja dhe verifikimi i ofertave, me cka edhe eshte bere hapja e tyre ne menyre publike. Sipas ligjit te prokurimit publik neni 58 pika 3 percaktohet vetëm mënyra e hapjes se ofertës tenderuese. Ligji nr. 04L-144 lidhur me kompetencat e komisionit vlerësues, neni 8 percakton: formimin e komisionit vlerësues dhe me kete përcaktim eshte qarte se komisioni vlerësues madje nuk ka kompetenca qe te marr mendim përfundimtar por vetëm te beje rekomandim pas vlerësimit te ofertave.

Kur kihet parasysh ky fakt kompetenca e komisionit per hapje eshte edhe me ulet dhe vendime nuk merren me te por vetëm behen rekomandime drejtuar komisionit per vlerësimin e ofertave. Po ashtu Udhezimi Administrativ i Qeverise se Republikes se Kosoves 23/2013 i dt: 22.08.2013 per përcaktimin e procedurave te dhënies ne shfrytëzim dhe këmbim te pronës se paluajtshme te komunës ne nenin 2 dhe 15 jane përcaktuar përbërja dhe funksioni i komisionit vlerësues po ashtu me kompetenca joekzekutive. Nga kjo rregullore shihet qarte se ky komision qe ka punu ne kete komision tenderimi ka vepru ne pajtim me ligjin nr 04L-144 me rregulloren e qeverise se lartepemendur, po ashtu me udhëzuesin operativ te prokurimit ne nenin 35 ku qarte jane përcaktuar detyrat dhe kompetencat e komisionit. Edhe njëherë e përsëris faktin se ky komision nuk ka pasur kompetenca ekskluzive, diskualifikimi i dy nga operatorët konkurrent eshte i baraspeshem sikurse ne nje konkurs punsimi aplikojnë konkurrentet dhe zyrtarja e pranimit te dokumentacionit, e kthen konkurrentin sepse fizikisht nuk i ka dokumentet. Ky nuk eshte diskualifikim por nuk jane plotësuar kushtet per te vazhduar tutje. Po ashtu duhet ti them edhe trupit gjykues se vepër penale pa te dëmtuar dhe pa pasoje nuk ka. Ne deshin e dëshmitarit te vetëm te këtij procesi me dt 30.10.2016 u dëshmuar qarte se ky komision ka vepruar ne përputhje me ligjet dhe me interesat e institucionit ku këta kane punuar dhe ne deklaratën e tij eshte cekur qarte se këta me punën e tyre i kane sjell nder dhe përfitime komunës dhe qytetarit te Skenderaj. Po ashtu se fakti se ne kete proces nuk ka te dëmtuar e dëshmon edhe parashtrësja 01.06.2016 nga K.Skenderajit e cila heq dore nga ndjekja penale dhe konsideron veten si te padëmtuar dhe heqë dore nga kërkesa pasurore juridike. Ne baze te provave materiale dhe ne baze te dëshmisë se dëshmitarit te vetëm z. F.N. gjate këtij shqyrtimi u vërtetua qarte se prokuroria e shtetit nuk ka mundur te argumentoj lidhjen kauzale me pasojën e veprës penale andaj vepër penale per te ekzistuar duhet te ekzistoj edhe lidhja shkakore me veprimet pasojat. Sipas komentarit te Kodit te Penal, fq. 1210 pika 11 po citoj: keqpërdorimi te ky nen e përcakton veprimi i caktuar dhe qëllimi i caktuar. Nuk eshte e thene qe cdo keqpërdorim te jete patjetër vepër penale, ne raste te caktuara ai mund te kete vetëm karakter te përgjegjësisë disiplinore. Duke u bazuar ne KPP ne shkresat e lendes provat materiale, dëshminë e dëshmitarit, Kodin Penal, Komentarin, shihet qarte se prokuroria nuk mundi te dëshmoj se veprimet e te mbrojtur sime kane perbere elementet e veprës penale per te cilën akuzohet, mbi kete baze trupit gjykues i propozoj qe pas administrimit te provave te marre aktgjykim lirues dhe te mbrojturën time ta liroj nga aktakuza ne baze te nenit 364 par. 1 nen par 1.1. pasi qe elemente te veprës penale nuk ka, prokurori i shtetit edhe pse e pa qe nuk u realizuan tezat e aktakuzës se tij e ka pare te udhës te mos heq dore nga kjo aktakuze. Edhe njëherë e përsëris propozimin qe ndaj te mbrojturës sime te marre aktgjykim lirues.

I akuzuari i peste N.H. ne mbrojtjen e tij ka deklaruar se une e kam pasur vendimin nga kuvendi komunal qe te jem ... i komisionit per hapjen e ofertave. Kemi shkuar ne komision, kemi hyre ne sallë te bordit te drejtoreve dhe kemi filluar per ti hapur ofertat, kane qene 5 ofertues, 2 kompani nuk i kane pasur letrat kurse 3 te tjera po. Letrat i kemi shikuar me rend te pestat dhe kemi dal prej salle e kemi kryer punën tone qe kemi pasur per detyre per ta kryer dhe me nuk ka qene pune e imja te interesohem per kete çështje përderisa na kane thirre ne Prishtine hetuesia nuk me ka interesuar mandej.

III. VENDIMET PROCEDURALE

Ne kete çështje penale ka qene i akuzuar edhe F.Z dhe me aktvendimin P.nr.77/2016 te dates 06.02.2017 eshte hudhur aktakuza e PPI.nr.281/2015 te dates 07.07.2016 dhe ka pushuar procedura penale kundër te akuzuarit F.Z. per shkak te veprës penale Keqperdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 81 te KPRK per shkak se i akuzuari ka vdekur me datën

IV. STANDARDET JURIDIKE

1. E drejta ne mbrojtje: Meqenese per kete vepër penale nuk eshte mbrojtja e obligueshme te gjithë te akuzuarit kane deklaruar se mbrojtjen do ta paraqesin vete me përjashtim te te akuzuarës V.J. e cila gjate tere shqyrtimit gjyqësor e ka angazhuar av. V.Rr..

2. Shyrtimi dhe vleresimi i provave: Gjykata ka pas parasysh dhe i ka vlerësuar të gjitha provat e aktakuzës dhe mbrojtjes dhe me aktgjykim do ti arsyetoj vetëm ato prova të cilat kanë të bëjnë me faktet vendimtare dhe do të nxjerr konkluzione vetëm për ato fakte te cilat janë thelbësore dhe të vlefshme për aktgjykim.

3. Standardi i te provuarit: Praktika gjyqësore për aktgjykimin fajsues e ka definuar si standard “dyshim i bazuar mire” sipas kuptimit të përgjithshëm dyshimi i bazuar mirë nënkupton posedimin e provave te pranueshme që do te bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri.

V. PROVAT

1.Gjatë procedurës së provave janë demonstruar këto prova: është dëgjuar dëshmitari F.N. i cili ka deklaruar: se Ligji 03/L-226 dhe 04/L-144 dhe Rregullorja e Qeverise se Kosovës nuk kane parapare procedurat per dhënien e pronave ne afat 1 vjecar dhe çështjen e kësaj procedure e kane rregulluar komunat me rregullore te brendshme ne kuadër te rregullore per taksa, ngarkesa dhe gjoba. Keto rregullore i nënshtrohen vlerësimit te detyrueshëm te ligjshmërisë nga ana e Ministrise se Administrimit te Pushtetit Lokal prandaj drejtoret kane vepruar konform te Rregullores e cila eshte miratuar ne kuvendin e komunës dhe i eshte nënshtuar vlerësimit te ligjshmërisë. Gjithashtu këto prona janë dhene duke u respektuar parimet sic janë: i ligjshmërisë, i efikasitetit, i ruajtjes se ambientit, i rritjes se vlerës se asaj prone dhe te njëjtën kohe eshte respektuar plani zhvillimor komunal urban. Sa i përket afatit ne kemi përcaktuar si afat te përkohshëm qe nënkupton periudhën 1 vjecare ose periudhën prej 12 muajsh qe ne komuna ne e quajmë si vit fiskal dhe Ligji ne fjale i

referohet te hyrave ne baze te Ligjit per Financat Publike dhe Pergjegjesite i cili percakton aspektin dhe çështjet financiare brenda nje viti fiskal dhe si te tille ne e kemi kualifikuar ne kete forme duke pasur parasysh parimin e efikasitetit ne menyre qe mos te ndryshojmë cdo vite kontrata, por kjo nuk nënkupton qe iu ka dhene ne shfrytëzim me tepër se nje vit duke shikuar se a i kane plotësuar obligimet e tyre ne menyre qe tiu vazhdohet edhe per vitin tjetër. Ne pyetjen e te akuzuarit H.G. se prej momentit qe kane filluar lokalet ne stadium te ipen me qira përmes asamblesë a ka përfituar komuna me tepër? Dëshmitari u përgjigj se përfitimi eshte i njejte. Ndersa ne pyetjen e te akuzuarit L.K. se si e cilësoni veprimin tim ne nënshkrimin e kontratave per dhënien e lokaleve me qira a mendoni se kam vepruar ne interesat e përgjithshme te komunës? Dëshmitari u përgjigj: me po dhe vlerësoj se kjo eshte plotësisht ne interesat e komunës sepse rinovimi dhe rregullimi i 16 lokaleve eshte bere përmes vendimit te kuvendit te komunës te cilat janë rregulluar me destinim per dhënie me qira e nga te cilat komuna ka krijuar te hyra vetanake.

Ndërsa sa i përket komisionit per hapjen dhe vlerësimin e ofertave deklaroi se detyra dhe kompetencat e komisionit ne procedurën parakualifikuese ka qene hapja dhe konstatimi i dokumentacioneve fizike sipas kriterëve te kërkuara mbi bazën te cilave janë kualifikuare ata te cilët e kane pasur dokumentacionin ne dosje. Pra ky komision nuk ka pasur kompetence me i vleresu as dokumentacionin por as kriteret e kërkuara per faktin se ka qene nje komision tjetër i themeluar ne kuvend per vlerësimin dhe procedimin e ofertuesve ne vendimmarrjen e kuvendit.

2. Provat materiale

Jane lexuar këto prova materiale:

- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,
- Kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira nr. ... dt: ...,

Aktvendimin nr. ... dt: ... me të cilin i lejohet **B.(H.) G.**, shfrytëzimi i përkohshëm i tokës nga prona publike komunale, kontratën mbi dhënien e tokës publike komunale dhe objekteve në shfrytëzim të përkohshëm me qira B.G. sipas aktvendimit nr.... e dt:

Aktvendimi nr.... dt: ... me të cilën ju lehoet **M.K.B.**, shfrytëzimi i përkohshëm i tokës nga prona publike komunale, kontrata mbi dhënien e tokës publike në shfrytëzim të përkohshëm me qira M.K.B. nr. ... dt:

Aktvendimi nr. ... dt: ... me të cilën i lejohet **F.H.** në shfrytëzim të përkohshëm, toka nga prona publike komunale, kontratën nr. ... e dt: ..., me të cilën i lejohet F.H. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.

Aktvendimi nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet **M.A.** në shfrytëzim të përkohshëm toka nga prona publike komunale, kontrata nr. ... dt. ..., me të cilën i lejohet M.A. toka publike komunale në shfrytëzim të përkohshëm me qira.

Aktvendimi nr. ... dt. ..., me të cilën i lejohet B.K. në shfrytëzim të përkohshëm toka nga prona publike komunale, kontratën ... e dt: ..., me të cilin i lejohet B.K. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.

- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet R.B.Xh., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet R.B.Xh. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet H.V.J., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet H.V.J. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet F.D., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet F.D. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet H.D., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet H.D. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet A.H.1, në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet A.H.1 toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet me kërkesën e firems “...” SHPK drejtor B.B. , në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet B.B. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet F.B., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet F.B. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet G.Xh., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet G.Xh. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet Xh.Xh., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet Xh.Xh. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet S.Xh., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet S.Xh. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet H.A., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata mbi dhënien e tokës publike në shfrytëzim të përkohshëm me qira e dt: ..., në mes të kuvendit komunal të Skenderajit të cilin e përfaqëson drejtori i

drejtoris per gjeodezi dhe kataster dhe pronsi i kësaj komune dhense e tokës publike dhe H.A. shfrytëzues i tokës.

- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet M.B., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet M.B. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet B.F., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet B.F. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet S.I.2., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet S.I.2. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet H.K., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet H.K. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet A.Q., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet A.Q. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Kontrat mbi dhënien e tokës publike ne shfrytëzim te perkoshum nr. ... e dates ... me te cilën i ipet ne shfrytëzim te perkoshum toka nga prona publike komunale me qera pronarit te diskotekës “...” B.L..
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet Sh.H., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet Sh.H. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Kontrat nr. ... dt: ... mbi dhënien e tokës publike ne shfrytëzim te përkohshëm me qira N.T.SH. “...” nga ... drejtor V.S..
- Kontrate nr. ... dt: ... mbi dhënien e tokesa publike ne shfrytëzim te perkoshem me qira R.B..
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet A.O., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet A.O. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet K.K., në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet K.K. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Aktvendimi nr. ... dt. ... me të cilin i lejohet Z.H. në shfrytëzim të përkohshëm toka publike komunale, kontrata nr. ... e dt: ... me të cilën i lejohet Z.H. toka publike komunale për shfrytëzim të përkohshëm me qira.
- Kontrate nr. ... dt: ... me te cilën i lejohet S.I.3 dhënia e lokalit afarist me qera.

- Kontrate nr. ... dt: ... me te cilën i lejohet A.H.2 dhënia e lokalit afarist me qera.
- Kontrate nr. ... dt: ... me te cilën i lejohet A.I. dhënia e lokalit afarist me qera.
- Kontrate mbi qiramarrjen dt: ... e lidhur mes Drejtorise per Kulture, Rini dhe sport te Komunes se Skenderajit me përfaqësues F.Z. dhe R.M..
- Vendimi mbi emërimin e anetareve te komisionit per caktimin e qerases per lokalet afariste nr.02/762 dt: 10.08.2011
- Procesverbali i anetareve te komisionit per caktimin e qerases per lokalet afariste dt: ..., dokumentacioni i bashkangjitur nga NTSH "...” per pjesëmarrje ne procedurën paraseleksionuese: ftesa e Drejtorisë se Urbanizmit ne Skenderaj dt: ... drejtuar NTSH "...” Skenderaj, deklaratën ne betim dt: ... te NTSH"...”, certifikatën tatimore ne emër te NTSH "...”, certifikatën e regjistrimit me nr te biznesit ... ne emër te NTSH "...”, certifikatën e numrit fiskal nr. ..., certifikatën-deklarimi i TVSH-se ne mer te NTSH "...”, vërtetimin e gjykatës ekonomike te gjykatës se Qarkut ne Prishtine nr. ... dt: ... leshuar ne emër te NTSH"...”, vërtetimi nr. ... dt: ... leshuar nga Kuvendi Komunal ne Skenderaj, me te cilin vërtetohet se NTSH. "...” ka kryer obligimet e tatimit ne prone, dëftesën e pagesës se energjisë elektrike nga A.S. ne shume prej 246.00 euro te dt: ..., diplomën ne emër te A.(K.) M.-ing. I diplomuar i ndërtimtarisë, kontratën e punës ne emër te A.M. të dt: ..., diplomën ne emër të A.(R.)J. leshuar në Universitetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës-ing., e diplomuar.

VI. ANALIZA E PROVAVE

Këto prova gjykata në bazë të nenit 361 të KPP me ndërgjegje i vlerësoi një nga një dhe në lidhje me prova tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë e vërtetojë këtë gjendje faktike si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Faktet jo kontestuese:

Nuk është kontestues fakti se i akuzuari H.G. gjatë periudhës kohore prej 17.11.2010 e gjerë me datën 08.07.2013 ka qenë ..., në komunën e Skënderajit dhe se në cilësinë të ... i ka nënshkruar kontratat për dhënien me qira të paluajtshmërisë publike në shfrytëzim të personave privatë.

Nuk është kontestues fakti se i pandehuri i dytë L.K. gjatë periudhës kohore prej datës 31.03.2014 e gjerë me datën 15.02.2015 ka qene ... në komunën e Skënderajit dhe se në cilësinë të ... i ka nënshkruar kontratat për dhënien me qira të paluajtshmërisë publike në shfrytëzim të personave privatë.

Fakte kontestuese:

Fakt kontestues eshte fakti se a e kane përfillur procedurën ligjore per dhënien e paluajtshmërisë publike me qira personave privatë.

Sipas dispozitave të **Ligjit Nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronë së paluajtshme të komunës**, neni 7 shprehmisht thuhet:

Procedura për dhënien e pronës publike komunale në shfrytëzim

- 1. Kuvendi i Komunës themelon Komisionin e posaçëm në përbërje të përfaqësuesve të ekzekutivit të komunës dhe Kuvendit të Komunës të cilët vlerësojnë ofertat dhe i propozon Kuvendit listën e ngushtë prej së paku tre pretendentëve kryesor për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike komunale.*
- 2. Kuvendi i Komunës, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, merr vendim me shumicën e anëtarëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.*
- 3. Vendimi i miratuar nga Kuvendi i Komunës duhet të përmbajë, por nuk kufizohet:*
 - 3.1. emrin i shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme publike komunale;*
 - 3.2. aktivitetin që do të ushtrojë në pronën e paluajtshme publike komunale;*
 - 3.3. përshkrimi i pronës së paluajtshme komunale e dhënë në shfrytëzim.*
 - 3.4. periudhën kohore dhe vendin e pronës së dhënë në shfrytëzim;*
 - 3.5. obligimet e palëve të pronës së paluajtshme publike komunale ndaj komunës gjatë dhe pas shfrytëzimit.*

Sipas **Ligjit në shfrytëzim dhe kombinimin e pronës së paluajtshme nr.04/L-144** shprehimisht thuhet:

Neni 7 Propozimi për dhënien e pronës publike të Komunës në shfrytëzim

- 1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës për miratim paraprak pronën e paluajtshme të Komunës për dhënien në shfrytëzim personave fizik dhe juridik, duke paraqitur arsyet dhe interesin publik.*
- 2. Propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës duhet të identifikojë emërtimin e pronës, madhësinë e saj, të specifikojë arsyet, qëllimet dhe kohëzgjatjen si dhe formën në të cilën rekomandohet procesi për dhënien e pronës në shfrytëzim.*
- 3. Kuvendi i Komunës merr vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.*

Neni 8 Komisioni vlerësues, detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1. Për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës afatshkurtër dhe afatgjatë, formohet Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, cili përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve.*
- 2. Kryetari i Komunës i propozon tre (3) anëtarë nga ekzekutivi i Komunës, Kuvendi i Komunës tre (3) anëtar nga subjektet e ndryshme të përfaqësuara në Kuvend, dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile.*
- 3. Propozimi për anëtarët e Komisionit aprovohet në Kuvendin e Komunës me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit.*
- 4. Vendimi i Kuvendit të Komunës për themelimin e Komisionit vlerësues duhet të përmbajë detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit dhe çështjet tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme për punën e Komisionit vlerësues.*
- 5. Njësit përkatëse të administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.*
- 6. Komuna është përgjegjëse dhe kujdeset për:*
 - 6.1. njoftimin publik për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.*
 - 6.2. njoftimi me shkrim duhet të postohet në ueb-*

faqen e Komunës, në vendet publike dhe në media lokale, elektronike dhe të shkruara. 4 6.3. njoftimi duhet të identifikojë emërtimin e pronës, lokacionin dhe përshkrimin e saj, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, çfarëdo kushti apo kufizimi mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim, shfrytëzimin e lejuar të tokës, formën e konkurrimit, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, përfshirë procedurat e regjistrimit të ofertuesve, kohën dhe vendin ku mbahet ankandi dhe hapjen e ofertave.

6.4. kohëzgjatja e shpalljes për dhënien e pronave për shfrytëzim afatshkurtër është jo më shkurt se tridhjetë (30) ditë, dhe për shfrytëzim afatgjatë jo më shkurt se dyzet e pesë (45) ditë.

6.5. anëtarët e komisionit duhet të jenë prezent në ankand dhe në hapjen publike të ofertave.

6.6. ofertat e mbyllura duhet të shpallen publikisht gjatë hapjes dhe të protokollohen.

6.7. Komisioni është autoritet për vlerësimin final të ofertave ekonomikisht më të favorshme, në pajtim me kriteret e përcaktuara me njoftimin për ankand dhe shprehje të interesit.

Trupi gjykues vërtetoi se dy të akuzuarit e pare nuk i kane përfillur dispozitat e Ligjeve të përshkruara me larte.

Te akuzuarit në mbrojtjen e tyre kane deklaruar se e kane zbatuar dispozitat e Ligjit mbi menaxhimin e financave, Rregullore mbi organizimin e brendshëm të Komunes dhe se sipas tyre kane vepruar në menyre ligjore në momentin kur kane lidhur kontratën mbi qiranë me personat private si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Trupi gjykues mbrojtjes se të akuzuarve nuk u dha besim pasiqe mbrojtja e tyre behet me qellim që të ikun përgjegjësisë penale dhe një mbrojtje të tillë gjykata nuk e pranoi.

Sipas dispozitave të **Ligjit nr.03L-226 neni 7** Kuvendi i komunës është dashur ta themelojë komisionin e posaçëm i cili do të vlerësonte ofertat dhe ky komision do të propozonte kuvendit tre pretendentë kryesorë për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike komunale.

Trupi gjykues vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit **H.G.** ekzistojnë elementet e veprës penale Keqperdorim i detyrës zyrtare nga neni 422 par.1 të KPRK-së pasiqë me veprimet e tij u ka shkaktuar dëm personave tjerë dhe ua ka shkelur të drejtat e personave tjerë.

Edhe sipas **Ligjit nr.04/L-144 neni 8** par.1 për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunes afatshkurte dhe afatgjate, formohet Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komune në shfrytëzim i cili përbehet prej 7 anetareve.

Gjate shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari H.G. i ka përfillur procedurat e përshkruara me larte.

Neni 8 par. 6 ku shprehimisht thuhet:

6. Komuna është përgjegjëse dhe kujdeset për:

6.1. njoftimin publik për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.

6.2. njoftimi me shkrim duhet të postohet në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike dhe në media lokale, elektronike dhe të shkruara.

6.3. njoftimi duhet të identifikojë emërtimin e pronës, lokacionin dhe përshkrimin e saj, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, çfarëdo kushti apo kufizimi mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim, shfrytëzimin e lejuar të tokës, formën e konkurrimit, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, përfshirë procedurat e regjistrimit të ofertuesve, kohën dhe vendin ku mbahet ankandi dhe hapjen e ofertave.

6.4. kohëzgjatja e shpalljes për dhënien e pronave për shfrytëzim afatshkurtër është jo më shkurt se tridhjetë (30) ditë, dhe për shfrytëzim afatgjatë jo më shkurt se dyzet e pesë (45) ditë.

6.5. anëtarët e komisionit duhet të jenë prezent në ankand dhe në hapjen publike të ofertave.

6.6. ofertat e mbyllura duhet të shpallen publikisht gjatë hapjes dhe të protokollohen.

6.7. Komisioni është autoritet për vlerësimin final të ofertave ekonomikisht më të favorshme, në pajtim me kriteret e përcaktuara me njoftimin për ankand dhe shprehje të interesit.

Kurse në:

Nenin 9 par.5 shprehimisht thuhet: *per zbatimin e vendimit te Kuvendit te Komunës obligohet Kryetari i Komunës te lidhë kontratë me te cilën përcaktohen te drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.*

Neni 9 par.6 shprehimisht thuhet: *Komisioni per vlerësimin e ofertës, per dhënien ne shfrytëzim afateshkurter te pronës se paluajtshme te komunës behet përmes ankandit. Oferta e përzgjedhur i dërgohet kryetarit per lidhjen e kontratës.*

Trupi gjykues vlerëson se i akuzuari L.K. ne baze te dispozitave te shënuara me larte nuk ka pasur te drejte qe ti nënshkruaj kontratat e përshkruara ne dispozitiv te aktgjykimit por kjo kompetence eshte kompetence e Kryetarit te Komunes.

Trupi gjykues vërtetoi se ne veprimet e te akuzuarit **L.K.** ekzistojnë elementet e veprës penale *Keqperdorim i detyrës zyrtare nga neni 422 par.1 te KPRK-së* pasi që me veprimet e tij u ka shkakuar dëm personave tjerë dhe ua ka shkelur të drejtat e personave tjerë, pasi që e ka pasur pozitën zyrtare (...) si dhe i ka tejkualuar autorizimet zyrtare (pasi që nuk ka pasur kompetencë qe ti nënshkruaj kontratat), e kete kontrate sipas dispozitave te Ligjit te shënuar me larte eshte ekskluzivisht kompetence e Kryetarit te Komunes.

VII. MATJA E DËNIMIT

Për veprën penale *Keqperdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422* parashihet denimi prej (gjashtë) 6 muaj deri në pesë (5) vjet.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit nga neni 73 dhe 74 të KPRK-së për të akuzuarin **H.G.** si rrethanë lehtësuese gjykata ka marrë: per here te pare ka rene ne kundërshtim me ligjin, eshte familjar, baba i katër fëmijëve, kurse rrethana renduese nuk ka gjetur.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit nga neni 73 dhe 74 të KPRK-së për të akuzuarin **L.K.** si rrethanë lehtësuese gjykata ka marrë: per here te pare ka rene ne kundërshtim me ligjin, eshte familjar, kurse rrethana renduese nuk ka gjetur.

Sa i përket pikës II trupi gjykues vlerësoi se:

Faktet jo kontestuese:

Nuk është kontestues:

Fakti se te akuzuarit: **H.S., V.J.** dhe **N.H.** me vendim te kryetarit te Komunes se Skenderajit janë emëruar ... te Komisionit per hapjen e ofertave.

Ky vendim perbehet nga tri nene dhe ne nenin 2 parashihet detyrat e komisionit ku ne menyre decisive shkruan: “detyre e komisionit nga neni 1 i këtij vendimi eshte qe te bene hapjen e ofertave dhe ti kryej procedurat përkatëse administrative konform dispozitave gjegjëse ligjore ne fuqi”.

Nuk eshte kontestues fakti qe te akuzuarit ne baze te këtij vendimi edhe e kane përfunduar punën e tyre dhe e kane përpiluar raportin me datën 31.01.2012.

Faktet kontestuese:

Fakt kontestues eshte se te akuzuarit a i kane ditur kompetencat e tyre si komision per hapjen e ofertave, ngase ne vendim shkruan se detyre e komisionit per hapjen e ofertave eshte qe te hapen ofertat dhe ti kryejnë procedurat përkatëse administrative.

Trupi gjykues se anetaret e komisionit per hapjen e ofertave nuk kane pasur njohuri per procedurat administrative pasiqe ne vendim eshte dashur qe ne menyre precize te precizohen qarte se çfarë detyre ka komisioni per hapjen e ofertave?

Duke marre parasysh nga deklaratat e tyre u vërtetua se per here te pare kane marre ne nje komision te tille dhe nuk kane pasur njohuri se cilat jane te drejtat dhe detyrat e tyre.

Trupi gjykues vlerëson se ne veprimet e te akuzuarve nuk sajohen elementet e veprës penale per te cilën ngarkohen pasiqe qe kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje te drejteperdrejte, e cila përfshin edhe dijeninë e kryesit se po e shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, po tejkalon kompetencat e tij ose nuk po e kryen detyrën e tij si dhe faktin se me kete përfiton dobi pasurore per vete apo per tjetrin ose i shkakton çfarë demi.

Ne rastin konkret te akuzuarit i kane tejkaluar kompetencat e tyre por nje tejkalim i tille eshte bere “pa dijenine” e te akuzuarve.

VIII. KËRKESA PASURORE JURIDIKE

Kerkese pasurore juridike nuk ka pasur.

X. SHPENZIMET E PROCEDURES

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marre në bazë të nenit 450 par.2.6 te KPP-se.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.77/2016, të datës 29.10.2017

PROCESMBAJTESJA
Hasnije Muhaxheri

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES
Beqir Halili

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit Gjykatës se Apelit ne Prishtine – Departamentit për krime te renda, e përmes kësaj gjykate.